

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 289, dt. 13.12.2016

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 13.12.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit për ndërtimin e Hidrocentraleve Vërnik 1,2,3, dhe 4 në Bashkinë Selenicë, Qarku Vlorë.
 2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objekteve monument kulture:
Ura e Bratit dhe Këmbët e urës antike në Kalanë e Cerjes, sipas projekt-preventivit të hartuar nga specialistët e DRKK-së Vlorë.
 3. Ngarkohet DRKK Vlorë për korrespondencën në vazhdim me shoqërinë dhe vënien në dijeni të Këshillit Kombëtar të Restaurimit për pikën 2 të këtij vendimi.
 4. Gjatë procesit të zbatimit, të projektit për ndërtimit të Hec-eve Vërnik, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar
 5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI